

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. E. nga fshati M. Komuna e Prizreni, për shkak të veprës penale te kanosjes nga neni 185 par.3 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.3098/2014 të dt.18.11.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Fatos Ajvazi, te akuzuarit, me datë **17.10.2017**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari A. E., nga i ati B., e ëma Z., e vajzërisë K. i lindur më dt. në fsh.M., Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, i martuar baba i 2 femijeve, i pa pune, është i gjendjes së dobët ekonomike, shkollën e mesme të kryer, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTE FAJTOR

Se me dt.25.11.2014, rreth ores 14,00 min, Stacionin Policor ne Prizren, seriozisht e kanos personin tjetër zyrtar ne lidhje me punen e tij, ne ate menyre qe shkon ne Stacionin Policor ne Prizren, dhe kontakton me nje zyrtar te policise lidhur me rastin qe djali i tij i mitur e kishte pasur nje dite me heret, ne momentin qe del ne korridor te Stacionit Policor, e veren te demtuarin- zyrtarin e policise A. B., ku i pandehuri i drejtonte me fjalet: tash per tash po ta njoh ftytyren, kur te dalim jasht do te mirremi vesh, ne ate moment nderhyne shefi i nderrimit Sh. R. dhe e qeteson situaten.

-kësodore ne bashkekryerje kane kryer veprën penale te kanosjes nga neni 185 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.


Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49 par.1 p.1, 50, 51, 73, 74, 75, e 76 dhe nenit 365 të KPK-ës, iu shqipton,

DENIM ME KUSHT

Duke i vertetuar denimin me burgim ne kohezgjatje prej **6 (gjashte) muaj**, i cili denim nuk do te ekzekutohet nese ne afatin kohor prej **1 (nje) viti**, nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, i akuzuari nuk do te kryen veper te re penale.

I akuzuari obligohet qe ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise te kesaj gjykate sado qe te jene ato, dhe ne emer të paushallit gjyqësor, shumen prej **30 Euro**, te gjitha keto ne afat prej 15 diteve, prej dites se plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi.

Arsyetim



Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr.3098/2014 te dt.18.11.2016, kunder te akuzuarit A. E. nga fshati M. Komuna e Prizreni, per shkak te vepres penale te kanosjes nga neni 185 par.3 lidhur me paragrafin 1 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimet te fajesis per vepren penale e cila iu vihete ne bare, e qe pranimi i fajesis eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale te kanosjes nga neni 185 par.3 lidhur me paragrafin 1 te KP-es, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe iu shqiptoi denimin me kusht, paraprakisht duke iu vertetuar pergjegjesia e tij penalo-juridike

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjelljet korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tij, duke i pasur parasysht dispozitat e nenit 74, 75 e 76, i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tij ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin dhe ka shprehur keqardhje per shkak te vepres se kryer penale, ka pasur sjellje korrekte para gjykes, eshte i gjendjes se dobet ekonomike, i pa pune, baba i dy femijeve, i kerkojne falje te demtuarit dhe me te njejtin e ka gjetur gjuhen e pajtimet dhe mirekuptimit, deri me tani i pa gjykuar, cka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi denimin me kusht sepse konsideron se me shqiptimin e denimit do te arrihet qellimi i denimit, prandaj i shqipton denimin me burgim ne kohezgjatje me nga 6 (gjashte) muaj, i cili denim nuk do te ekzekutohet nese ne afatin prej 1 (nje) viti, dhe nese te njejtin nuk kryejne veper te re penale, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tyre dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jene te kujdesshem dhe do te permbahen nga veprimet e tiila te karakterit penal.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450,e 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 2549/2016 të dt. 17.10.2017

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari



UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgykimi palet e pakenaqura kane te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.